



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 231 prot.

Tiranë më 29.01.2018

**VENDIM**

Nr. 3, datë 29.01.2018

**PËR**

**RRËZIMIN E ANKESËS**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**V Ë R E N:**

Ankuesi, Z. \_\_\_\_\_, në cilësinë e përfaqësuesit të Qendrës BIRN Albania, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1360 Prot., datë 12.10.2017, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Me kërkesën e datës 12.09.2017 ankuesi ka kërkuar informacion/dokumente zyrtare në lidhje me procedimin penal nr. 1098 datë 02.05.2014 që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan kishte dërguar për kompetencë pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Me shkresën nr. 3571 prot. datë 26.09.2017 Autoriteti Publik i ka vënë në dispozicion kërkuarit Vendimin e pushimit të procedimit penal. Me kërkesën e datës 28.09.2017 ankuesi ka vijuar kërkesën e tij duke kërkuar t’i vihet në dispozicion kopje e plotë e fashikujve të procedimit penal nr. 1305.

Me shkresën nr. 3887 Prot., datë 04.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “Informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion pasi nuk përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Aktet e kërkuara në zbatim të gërmës dh) të pikës 2, të nenit 17 të ligjit të sipërcituar, kufizohen nga ligji, pasi

*kanë të dhëna me karakter personal. Dokumentacioni i kërkuar ka për objekt akte procedurale, të cilat rregullohen nga ligji 89/2017 "Kodi i Procedurës Penale", më konkretisht në nenin 103 të tij është parashikuar se: Ndalohet publikimi, qoftë dhe i pjesëshëm i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose vetëm i përmbajtjes së tyre ndërmjet shtypit ose informacionit masiv. Subjekti duhet të legjitimohet për të marrë kopje të akteve të dosjes penale".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankimin nr. 1360 Prot., datë 12.10.2017 duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1360/1 Prot, datë 07.11.2017, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni në përputhje me pikën 6, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe me parimet e neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Autoriteti Publik është përgjigjur me shkresën nr. 4688 Prot., datë 05.12.2017 duke refuzuar dhënien e informacionit me arsyetimin se: "*Aktet e procedimit penal nr. 1305 përmbajnë të dhëna që, nëse shpërndahen dëmtojnë të drejtën për një jetë private për shkak të të dhënave personale, si edhe sekretin tregtar të subjekteve të ndryshëm vendas e të huaj. Gjithashtu, refuzimi i kërkesës bazohet edhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, për shkak të natyrës sekrete të akteve hetimore.*"

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "*Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ....kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore.*

Me shkresën nr. 1360/3 Prot., datë 12.12.2017, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore e cila u zhvillua me datë 05.01.2018. Ankuesi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Gjithashtu gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore u konstatua se njëra nga palët, dhe më konkretisht Z. është palë në një proces gjyqësor, objekti i të cilit lidhet me informacionin që përbën dhe objektin e kërkesës së ankuesit.

Bazuar në këtë rrethanë, pavarësisht se informacioni i kërkuar nga Z. përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloji forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik", dhe në parim konsiderohet informacion publik, Komisioneri vlerëson se në rastin konkret, e drejta e informimit kufizohet në përputhje me nenin 17, pika 2, germa dh. duke qenë se mund të cënojë barazinë e palëve gjatë procesit gjyqësor, për arsye se interesat e ligjshëm të palëve dhe çdo kërkesë për dokumentacion apo informacion rregullohet sipas ligjit procedural të zbatueshëm.*



Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. \_\_\_\_\_ kundër Autoritetit Publik "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë", Komisioneri vlerëson se informacioni nuk mund të vihet në dispozicion për shkak të kufizimit të arsyetuar më sipër.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankimit nr. 1360 Prot., datë 12.10.2017 të Z. \_\_\_\_\_ kundër Autoritetit Publik "Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë".
2. Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u dha sot në datë 29 . 1 .2018.

KOMISIONERI  
Besnik Dervishi



The image shows a circular official stamp with a blue border. Inside the stamp, there is a grid of small text, likely a stamping code or date. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink that reads "Besnik Dervishi".